



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ____ / ____ / 2026

PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 50, DATË 21.05.2025, "PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË Durrës, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUNDI I RI, TË PASURISË ME NR. 101/2, E LLOJIT TRUALL, ME SIPËRFAQE 1664 M², ME VENDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 3541"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.2, shkronjat "a" dhe "c", nenit 23, pika 13, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, shkresës nr. 373/3 prot., datë 03.12.2025, ardhur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Pronave Shtetërore, Kodi i Procedurave Administrative, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, Kryetari i Bashkisë, i propozon Këshilli Bashkiak,

PËR TË VENDOSUR :

1. Miratimin për disa ndryshime në vendimin e këshillit bashkiak nr. 50, datë 21.05.2025, "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Katundi i Ri, të pasurisë me nr. 101/2, e llojit truall, me sipërfaqe 1664 m², me vendodhje në zonën kadastrale 3541", për shkak të nevojës për përafrim të sipërfaqes së pasurisë me gjendjen faktike në terren, siç rezulton nga verifikimi i kryer nga ASHK Tiranë, duke ndryshuar sipërfaqen e kërkuar për transferim sipas të dhënave të pasqyruara në planrilevimin dhe formularin e inventarizimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Miratimin e planrilevimit dhe formularin e inventarizimit të përditësuar, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtor
Alcinda Rroshi

KRYETAR

Emiliana Sako

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI SHTET

DATE 10/12/2025

QELIMI PER TRANSFERIM

VENDODHJA

BASHKIA DURRËS

DVASHK DURRËS

ZONA KADASTRALE 3541

NUMRI I PASURISE 101/2

INDEKSI I HARTËS K-34-88-(209-D)

TË DHËNAT E PASURISË

LLOJI I PASURISË TRUALL

SIPERFAQJA E PASURISË = 1664 m2

ZONA KADASTRALE 3541

NUMRI I KATEVE

NUMRI I PEMËVE


X 459698.1345

Y 4583495.0713

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 460387.5204

Y 4583495.0713



SH 1:2500

X 459698.1345

Y 4583072.2719

X 460387.5204

Y 4583072.2719

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	V-			291		
2	L-			297		
3	J-			101/3		
...	P-			101/1		

REALIZOI PËR BASHKINË DURRËS

PUNOI: FATJON ZEIQIRI

NËNASHKRIMI: ANILA MUHJA

PERGJEGJES: JETMIR PUPLA

NËNASHKRIMI:

DREJTORI: ALNEIDA RROSHI

NËNASHKRIMI:

ZEVENDESKRYETAR: GENTIAN KALLMI

NËNASHKRIMI/VULA:

REALIZOI PËR DVASHK

SPECIALISTI:

NËNASHKRIMI:

KONFIRMOI

PERGJEGJES/DREJTORI:

NËNASHKRIMI/VULA:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

Ky plan rilevimi është hartuar me qëllim transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës të pas. nr. 101/2, e llojit Truall, me sip.1634 m2, me vendodhje në ZK 3541. Aktualisht në këtë truall është ngritur një ndërtesë me sip.102 m2, sipas lejes së ndërtimit nr. 1149-24/5, datë 11.03.2025. Objekti ka destinacion "Qendër e trajtimit të kafshëve të rrugës, për të cilën është kërkuar dhe transferimi.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI

NËNASHKRIMI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

RELACION

PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 50, DATË 21.05.2025, "PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUNDI I RI, TË PASURISË ME NR. 101/2, E LLOJIT TRUALL, ME SIPËRFAQE 1664 M², ME VENDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 3541"

Para Këshillit Bashkiak

K ë t u

Siç jeni në dijeni me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 50, datë 21.05.2024 është miratuar:

1. Kërkesa për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Katund i Ri, të pasurisë me nr. 101/2, e llojit truall, me sipërfaqe 1664 m², me vendodhje në zonën kadastrale 3541, për t'u përdorur në funksion të zbatimit të projektit "Qendër strehimi dhe trajtimi për kafshët", sipas formularit, gjithsej 1 (një) fletë dhe planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi i shtohet listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 431, datë 15.05.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Katundi i Ri, të Qarkut të Durrësit".

Sipas procedurës vendimi i mësipërm së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor i është përcjellë për vazhdim procedure ASHK, Drejtorisë së Pronave Shtetërore Tiranë, e cila sipas ligjit nr. 111/218, "Për Kadastrën" dhe ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" ka detyrimin për të hartuar projekt vendimin për miratim në Këshillin e Ministrave për miratim për transferimin përfundimtar të pasurisë me nr. 101/2, e llojit truall, me sipërfaqe 1664 m², me vendodhje në zonën kadastrale 3541, Katund i Ri.

Ka rezultuar se ASHK ka konstatuar një gabim në hartimin e planrilevimit të pasurisë për të cilën është kërkuar transferim tek Bashkia Durrës. Konstatimi qëndron në faktin se ka mospërputhje me të dhënat e marra nga kartela e pasurisë nr. 101/2, me gjendjen në fakt (teren). Sipas kartelës sipërfaqja e pasurisë objekt shqyrtimi është 1664 m², ndërsa nga matjet në terren, konturi i pasurisë del 1634 m². Ndodhur para këtij fakti, ASHK, Drejtoria e Pronave Shtetërore, me shkresë nr. 373/3 prot., datë 03.12.2025, me lëndë: "Kërkesë për saktësim dokumentacioni", administruar në Bashki me nr. 8847/3 Prot., datë 05.12.2025, orienton korrigjimin e mospërputhjes duke hartuar planrilevimin e pronës sipas gjendjes në terren dhe jo në të dhënat e marra nga kartela e pasurisë. Ky korrigjim do të reflektohet dhe në formularin e inventarizimit, e cila kërkon miratimin nga

Këshilli Bashkiak, në mënyrë që të vijojë procedura e transferimit. Duke qenë se transferimi i pasurisë në pronësi të Bashkisë Durrës është në interes publik dhe në funksion të realizimit të një objekti me rëndësi komunitare, paraqitet e nevojshme që Këshilli Bashkiak të miratojë ndryshimin e sipërfaqes së pasurisë në përputhje me gjendjen reale të konstatuar në terren. Ndryshimi i propozuar nuk sjell ndryshim në destinacionin, kufijtë apo karakteristikat funksionale të pasurisë, por synon vetëm përputhjen e dokumentacionit me të dhënat e përditësuara zyrtare të administruara nga ASHK Tiranë. Për këto arsye, propozohet miratimi i ndryshimit në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 50, datë 21.05.2024, sipas planrilecimit dhe formularit të inventarizimit me qëllim vijimin e procedurave të transferimit të pasurisë në pronësi të Bashkisë Durrës.

Pjesë e këtij relacioni është:

1. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 50, datë 21.05.2024, që kërkohet të ndryshohet
2. Shkresa nr. 373/3 prot., datë 03.12.2025, me lëndë: “Kërkesë për saktësim dokumentacioni”, administruar në Bashki me nr. 8847/3 Prot., datë 05.12.2025, ardhur nga ASHK, Drejtoria e Pronave Publike Tiranë.
3. Plan rilevimi i pronës i përditësuar sipas rekomandimeve të dhëna nga ASHK Tiranë me shkresën nr. nr. 373/3 prot., datë 03.12.2025.
4. Formular inventarizimi i pronës i përditësuar, bazuar në planrilevimin e përmirësuar.

**SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE, MENAXHIMIT
TË ASETJEVE DHE PROCEDURAVE
TË SHPRONËSËSIMIT**

Jetmir Pupla



DREJTORIA LIGJORE

Alneida Rroshi

